


KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

INDEKSI I TRANSPARENCËS PROAKTIVE I NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

DHJETOR 2022



www.idp.al

Përmbajtja

Hyrje	3
Metodologjia.....	5
Indeksi i Transparencës Proaktive për Njësiti e Vetëqeverisjes Vendore	11
Gjetjet përfundimtare “Indeksi i Transparencës Proaktive për Njësiti e Vetëqeverisjes Vendore”	16

Hyrje

E drejta për informim është e drejta e qytetarëve për të patur akses në dokumente zyrtare dhe detyrimi i autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë pa kërkuar motivet. E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila pas miratimit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ka sjell një garanci më të madhe ligjore për aksesin e qytetarëve në informacion dhe kushtet e duhura të transparencës proaktive për të ushtruar të drejtat e tyre.

Një nga risitë e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, është dhe përgatitja dhe miratimi i programeve të transparencës sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nëpërmjet Programit të Transparencës, i cili publikohet në faqen zyrtare, bashkitë vendosin në dispozicion të qytetarëve një kategori të gjerë informacionesh, përcaktojnë mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre, si dhe procedurat për të aksesuar e përdorur këtë informacion.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018, ka miratuar “Programin Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, i cili është i detyrueshëm për t’u implementuar nga 61 bashkitë e vendit që prej 1 janarit 2019. Programi model është hartuar në përputhje me kërkesat e nenit 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, dhe i përshtatur në kontekstin e vetëqeverisjes vendore, në përputhje dhe në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe të ligjit nr. 8548, datë 11.11.1999, “Për ratifikimin e “Kartës evropiane të autonomisë vendore”.

IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS

[Vendos emrin e bashkisë]

Fusha 1 - Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë						
Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës publikimin për
1.	<p>Organizimi administrativo-territorial, misioni dhe funksionet. Bashkia bën publike:</p> <p>1. Ndarjen administrativo-territoriale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësitë administrative dhe nën-ndarjet e tyre <p>2. Të drejtat, përgjegjësitë dhe misionin e bashkisë.</p> <p>3. Funksionet: Përfshin bërjen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Funksioneve në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike - Funksioneve në fushën e shërbimeve sociale - Funksioneve në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese - Funksioneve në fushën e mbrojtjes së mjedisit - Funksioneve në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit - Funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik vendor - Funksioneve në fushën e sigurisë publike - Funksionet dhe kompetencat e deleguara 	<p>Neni 7 i ligjit Nr. 119/2014</p> <p>Ligji Nr. 115/2014</p> <p>Neni 23-30 i ligjit nr. 139/2015</p>	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve)</p>	Menjëherë	Sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.	Kryetari i Bashkisë
2.	<p>Organi përfaqësues i Bashkisë-Këshilli bashkiak (përberja, strukturat, detyrat dhe kompetencat). Përfshin bërjen publike të:</p> <p>1. Këshilli bashkiak (KB):</p> <p>1.1 Përberja dhe strukturat</p> <ul style="list-style-type: none"> - Anëtarët - Kryetari i këshillit - Sekretari i këshillit - Komisionet 	<p>Neni 7 i ligjit Nr. 119/2014</p> <p>Ligji Nr. 139/2015</p>	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve)</p>	Menjëherë	<p>Vendimet e KB - brenda 10 ditëve nga data miratimit të tyre.</p> <p>T'hirra e mbledhjes - Kryetari i KB</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p> <p>Sekretari i Këshillit Bashkiak</p>

Një nga fazat e rëndësishme në sigurimin e transparencës në nivel vendor është edhe monitorimi i zbatimit të Programit të Transparencës. Monitorimi lejon të vlerësohet niveli i transparencës në nivel bashkie. Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbikëqyr respektimin e dispozitave të ligjit për të drejtën e informimit dhe në rastet kur vërehet mosrespektimi i tyre, bën vlerësimin e kundravajtjeve dhe vendos masën administrative përkatëse.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë gjithë vitit 2022, monitoroi faqet zyrtare të 61 njësive të vetëqeverisjes vendore. Pas monitorimit online për zbatimin e Urdhrit nr. 211 datë 10.09.2018, “Programi Model i Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, ka rezultuar se një pjesë e bashkive kanë pasur mangësi në publikimin e informacionit të detyrueshëm në rubrikat e këtij programi.

Nga monitorimi u konstatuan problematika të cilat kishin të bënin me rishikimin/përditësimin/zbatimin e programit të transparencës së njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe pasqyrimin në të, të të gjithë kategorive të informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik në përputhje me

parashikimet në nenin 7, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Si rezultat i këtyre problematikave, Zyra e Komisionerit ka zhvilluar 15 hetime administrative ndaj njësive të vetëqeverisjes vendore me objekt, vënien në zbatim të programit të transparencës. Në përfundim të procesit të hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit konstatoi përmbushjen e detyrimit të publikimit të programeve të transparencës nga ana e 14 njësive të vetëqeverisjes vendore, ndërkohë vetëm një (1) njësi e vetëqeverisjes vendore i është lënë afat për përmbushjen e detyrimeve, në fillim të vitit 2023.

Transparenca proaktive nëpërmjet publikimit të informacioneve në Programin e Transparencës kërkon impenjimimin e institucioneve publike për ta përditësuar, plotësuar dhe pasuruar me informacion në mënyrë të vazhdueshme. Për këtë arsye, monitorimi i transparencës të njësive të vetëqeverisjes vendore kryhet në bazë vjetore, duke lehtësuar kështu kryerjen e analizave krahasimore në të ardhmen.

Zyra e Komisionerit përtej angazhimit të saj institucional në monitorimin e zbatimit të detyrimit ligjor për miratimin, publikimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës, sjell për vitin e tretë radhazi “Indeksin e Transparencës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”. Ky indeks ndjek një metodologji të caktuar e cila shërben kryesisht për të sjellë një analizë krahasuese të nivelin e transparencës proaktive të njësive të vetëqeverisjes vendore, duke krahasuar trendin e transparencës së tyre ndër vite.

Gjetjet e këtij monitorimi dhe indeksi synojnë jo vetëm të nxisin njësitet e vetëqeverisjes vendore për të rritur nivelin e transparencës përmes publikimit proaktiv të informacionit, por ato shërbejnë edhe si një referencë përpara vendimmarrjes së Zyrës së Komisionerit në respektim të dispozitave ligjore.

Metodologjia

Sistemi i matjes i përdorur në këtë monitorim i referohet 9 treguesve kryesorë, të cilët bëjnë vlerësimin objektiv të nivelit funksional të transparencës proaktive të njësive të vetëqeverisjes vendore. Numri total i pikëve të vlerësimit të treguesve është 9 (nëntë). Bazuar në pikëzimin e çdo treguesi llogaritet shuma totale e vlerësimit për secilën bashki.

Instrumenti kryesor për matjen e transparencës proaktive është publikimi i Programit Model të Transparencës në faqen zyrtare të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Sistemi i matjes i përdorur në këtë metodologji është i thjeshtë dhe lejon një vlerësim të shpejtë të treguesve bazuar në gjendjen reale të tyre në momentin e kërkimit në faqen zyrtare të internetit.

Ky sistem krijon mundësinë e përdorimit të menjëhershëm për shkak të lehtësisë së përdorimit dhe shpejtësisë, në arritjen e përfundimeve në lidhje me përcaktimin e nivelit të transparencës.

Sistemi i matjes së transparencës përfshin 9 tregues të transparencës me qëllim matjen dhe raportimin në mënyrë periodike të nivelit të transparencës në secilën bashki. Një sistem i tillë i shërben Zyrës së Komisionerit si një bazë për të monitoruar nivelin funksional të transparencës, me qëllim evidentimin e progresit, pikat e dobëta dhe të forta.

Ky sistem matje i transparencës proaktive i referohet dhe është i ngjashëm me sistemin e matjes së transparencës së njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2021, i cili është i publikuar në faqen zyrtare të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në linkun: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2022/01/Indeksi_-i-transparences_monitorim_bashkite.pdf. Indeksi i Transparencës për vitin 2022 ka një përmirësim në krahasim me atë të një viti më parë. Ky përmirësim është një përmirësim sasior i të dhënave, të përfshira në këtë indeks. Në këtë indeks janë marrë në analizë 9 kategori informacioni përkundrejt 5 kategorive të mëparshme në vitin 2021.

Ndërkohë sistemi i matjes së treguesve vazhdon të jetë i njëjti si ai i vitit 2021. Matja e treguesve është kryer me 3 nivele: 0 pikë në rast se informacioni nuk është publikuar; 0,5 pikë kur informacioni është publikuar pjesërisht dhe 1 pikë kur informacioni është i publikuar plotësisht.

Më poshtë gjenden të listuar të nëntë treguesit e analizuar.

Treguesi i parë:

Publikimi i Programit Model të Transparencës për Autoritetet Publike sipas urdhrit të Komisionerit nr. 211, datë 10.09.2018, “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”,

Vlerësimi: 0-informacioni nuk është publikuar
 0,5-informacioni është publikuar pjesërisht
 1-informacioni është i publikuar

Treguesi i dytë¹:

Të dhënat e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit,

Vlerësimi: 0-informacioni nuk është publikuar
0,5-informacioni është publikuar pjesërisht
1-informacioni është i publikuar

Treguesi i tretë²:

Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve i përditësuar gjatë vitit 2022, sipas urdhrin nr. 188, dt. 18.12.2020, “Për miratimin e Regjistrin të Kërkesave dhe Përgjigjeve të Rishikuar”,

Vlerësimi: 0 - informacioni nuk është publikuar
0,5-informacioni është publikuar pjesërisht (nuk është vendosur përgjigja e kërkesës për informacion)
1-informacioni është i publikuar

¹ Do të shënohen me * të dhënat mbi Koordinatorët për të Drejtën e Informimit të caktuara nga Autoriteti Publik dhe për të cilat është njoftuar Zyra e Komisionerit. Kjo e fundit përditëson të dhënat e koordinatorëve në portalin pyetshtetin.al. Në indeks këto NjVV do të shënohen me * dhe do të renditen poshtë NjVV të cilat kanë grumbulluar të njëjtat pikë.

² Do të shënohen me ** “Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve” përcjellë me e-mail pranë Zyrës së Komisionerit. *Bazuar në nenin 8 të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”* . “Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik...”. Për sa më sipër, gjatë vitit 2022 disa koordinatorë për të drejtën e Informimit, për shkak të vështirësive teknike si rezultat i mungesës së stafit IT pranë autoriteteve publike kanë hasur vështirësi në publikimin e regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve. Për këtë arsye, pasi kanë publikuar regjistrin e përditësuar të kërkesave dhe përgjigjeve, pranë zyrave të tyre, kanë njoftuar Zyrën e Komisionerit nëpërmjet e-mailit. Për sa më sipër, në indeks do të mbahet parasysh dhe përgjigjja e dërguar me e-mail nga ana e koordinatorëve dhe në rast se në dokumentin bashkëlidhur regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve është mbajtur sipas modelit të miratuar nga Zyra e Komisionerit do të shënohet me 1**, nëse nuk është mbajtur sipas modelit do të shënohet me 0.5**. Ndërkohë që në mbledhjen e pikëve për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore do të evidentohet si ** dhe do të renditen poshtë NjVV të cilat kanë grumbulluar të njëjtat pikë. Do të shënohen me 0 ato njësi të vetëqeverisjes vendore të cilat nuk kanë publikuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve dhe as nuk kanë njoftuar Zyrën e Komisionerit.

Do të shënohen me ***, në totalin e pikëve të grumbulluara nga NjVV për ato bashki të cilat kanë përcjellë me e-mail pranë Zyrës së Komisionerit, caktimin e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit si dhe Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve.

Treguesi i katërt:

Publikimi i të dhëna PBA 2022-2024

Vlerësimi: 0 - informacioni nuk është publikuar
0,5-informacioni është publikuar pjesërisht
1-informacioni është i publikuar

Treguesi i pestë:

Publikimi i raporteve të auditimit dhe monitorimit (psh, Raporte KLSH ose Raporte Auditit të Brendshme)

Vlerësimi: 0-informacioni nuk është publikuar
0,5-informacioni është publikuar pjesërisht
1-informacioni është i publikuar

Treguesi i gjashtë:

Publikimi i Cv së titullarit

Vlerësimi: 0-informacioni nuk është publikuar
0,5-informacioni është publikuar pjesërisht
1-informacioni është i publikuar

Treguesi i shtatë:

Publikimi i strukturës së Autoritetit Publik

Vlerësimi: 0-informacioni nuk është publikuar
0,5-informacioni është publikuar pjesërisht
1-informacioni është i publikuar

Treguesi i tetë:

Publikimi i legjislacionit.

Vlerësimi: 0-informacioni nuk është publikuar

0,5-informacioni është publikuar pjesërisht

1-informacioni është i publikuar

Treguesi i nëntë:


Publikimi i informacionit mbi “Të dhënat e Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin publik”.

Vlerësimi: 0-informacioni nuk është publikuar

0,5-informacioni është publikuar pjesërisht

1-informacioni është i publikuar

Pas monitorimit për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore për 9 kategoritë e mësipërme, numri i pikëve do të mblidhet për secilën prej tyre dhe do të renditen në një indeks duke filluar nga bashkia e cila ka grumbulluar më shumë pikë, duke zbritur deri tek ajo me numrin më të ulët të pikëve.



Për të evidentuar më mirë, qasjen ndaj transparencës proaktive të njësisve të vetëqeverisjes vendore, Zyra e Komisionerit për të tretin vit radhazi paraqet sistemin e matjes të transparencës proaktive nëpërmjet një sistemi semafor.

Autoritetet Publike që i kanë të gjithë treguesit negativ dhe për këtë arsye kanë grumbulluar 0-2 pikë, kanë një transparencë proaktive të pamjaftueshme dhe në semafor shënohen me dritë të kuqe.

Autoritetet Publike që kanë grumbulluar 2.5-4.5 pikë, kanë një transparencë proaktive të ulët dhe në semafor janë shënuar me dritë të verdhë.

Autoritetet Publike që kanë grumbulluar 5-8 pikë, kanë një transparencë proaktive mesatare dhe në semafor janë shënuar me dritë të bardhë.

Autoritetet Publike të cilat i kanë të gjithë treguesit pozitiv dhe kanë grumbulluar 8.5-9 pikë, kanë një transparencë proaktive të lartë dhe në semafor janë shënuar me dritë të gjelbër.

Indeksi i Transparencës Proaktive për Njësiti e Vetëqeverisjes Vendore

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoroi në muajin nëntor - dhjetor faqet zyrtare të 61 njësive të vetëqeverisjes vendore.

Në tabelën e mëposhtme janë evidentuar 9 treguesit kryesorë të monitorimit të cilat janë: publikimi i programit të transparencës sipas urdhrit nr.211, datë 10.09.2018, “Për Miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësiti e Vetëqeverisjes Vendore”; publikimi i të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit; publikimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve i rishikuar për vitin 2022, *publikimi i të dhënave PBA 2022-2024*; *publikimi i raporteve të auditimit dhe monitorimit (psh Raporte KLSH ose Raporte Auditit të Brendshme)*; *publikimi i Cv të titullarit*; *publikimi i strukturës së Autoritetit Publik*; *publikimi i legjislacionit*; *publikimi i informacionit mbi “Të dhënat e Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin publik” për njësiti e vetëqeverisjes vendore për vitin 2022.*

Nr.	Autoriteti Publik	Programi i Transparencës	Koordinatori për të Drejtën e Informimit	Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve	PBA 2022-2024	Raporte auditimi dhe monitorimi	Cv e titullarit	Struktura e Autoritetit Publik	Legjislacioni	Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik	Totali
1	Bashkia Malësi e Madhe	1	1	1	1	1	1	1	1	1	9
2	Bashkia Mirditë	1	1	1	1	1	1	1	1	1	9
3	Bashkia Patos	1	1	1	1	1	1	1	1	1	9

4	Bashkia Prenjas	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	9
5	Bashkia Shkodër	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	9
6	Bashkia Skrapar	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	9
7	Bashkia Tiranë	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	9
8	Bashkia Dropull	1	1	0.5	1	1	1	1	1	1	1	8.5
9	Bashkia Finiq	1	1	0.5	1	1	1	1	1	1	1	8.5
10	Bashkia Klos	1	1	1	1	0.5	1	1	1	1	1	8.5
11	Bashkia Korçë	1	1	0.5	1	1	1	1	1	1	1	8.5
12	Bashkia Mat	1	1	0.5	1	1	1	1	1	1	1	8.5
13	Bashkia Dimal	1	1	0.5	1	1	1	1	1	1	1	8.5
14	Bashkia Peqin	1	1	1	1	0.5	1	1	0.5	1	1	8
15	Bashkia Pogradec	1	1	0.5	1	0.5	1	1	1	1	1	8
16	Bashkia Poliçan	1	1	1	1	0	1	1	1	1	1	8
17	Bashkia Vlorë	1	1	1	1	0	1	1	1	1	1	8
18	Bashkia Berat	1	1	1	1	0	1	1	0.5	1	1	7.5
19	Bashkia Lezhë	1	1	0.5	1	0	1	1	1	1	1	7.5
20	Bashkia Pustec	1	1	1	1	1	1	1	0.5	0	1	7.5

21	Bashkia Selenicë	1	1	0.5	0	1	1	1	1	1	7.5
22	Bashkia Shijak	1	1	0.5	1	0	1	1	1	1	7.5
23	Bashkia Vau i Dejës	1	1	0.5	0	1	1	1	1	1	7.5
24	Bashkia Sarandë	1	1	0.5**	1	1	1	1	1	0	7.5**
25	Bashkia Belsh	1	1	0.5	0	1	1	1	0.5	1	7
26	Bashkia Delvinë	1	1	0	1	1	1	1	1	0	7
27	Bashkia Himarë	1	1	1	0	0	1	1	1	1	7
28	Bashkia Kamëz	1	1	1	1	0	1	1	1	0	7
29	Bashkia Kolonjë	1	1	0.5	1	0.5	1	1	1	0	7
30	Bashkia Krujë	1	1	0	1	0	1	1	1	1	7
31	Bashkia Përmet	1	1	0.5	1	1	1	1	0.5	0	7
32	Bashkia Vorë	1	1	1	1	0	1	1	1	0	7
33	Bashkia Roskovec	1	1	1	1	0	1	1	0	1	7
34	Bashkia Elbasan	1	1	0.5**	1	0	1	1	0.5	1	7**
35	Bashkia Pukë	1	1	0.5**	1	0.5	1	1	1	0	7**
36	Bashkia Bulqizë	1	1	0.5	1	0	0	1	1	1	6.5
37	Bashkia Dibër	1	1	1	1	1	0	1	0.5	0	6.5

38	Bashkia Gramsh	1	1	1	1	0	0	1	0.5	1	6.5
39	Bashkia Libohovë	1	1	0.5	0	1	0	1	1	1	6.5
40	Bashkia Tropojë	1	1	0.5	1	0	1	1	1	0	6.5
41	Bashkia Cërrik	1	1	0.5	0	1	1	1	0.5	0	6
42	Bashkia Këlcyrë	1	1	0.5	0	0	1	1	1	0	5.5
43	Bashkia Kuçovë	1	1	0.5	0	0	0	1	1	1	5.5
44	Bashkia Librazhd	1	1	0.5	1	0.5	1	0	0.5	0	5.5
45	Bashkia Mallakastër	1	1	0.5	0	0	0	1	1	1	5.5
46	Bashkia Memaliaj	1	1	0.5**	0	1	0	0	1	1	5.5**
47	Bashkia Devoll	1	1	0.5**	0	0	1	1	0.5	0	5.5**
48	Bashkia Durrës	1	1	1	0	0	1	1	0	0	5
49	Bashkia Kukës	1	1	1	0	0	0	1	1	0	5
50	Bashkia Maliq	1	1	0.5	1	0	0		0.5	1	5
51	Bashkia Konispol	1	1	1**	0	0	1	0	1	0	5**
52	Bashkia Kurbin	1	1	1**	0	0	0	1	1	0	5**
53	Bashkia Has	1	1	0.5	1	0	0	0	1	0	4.5
54	Bashkia Gjirokastrë	1	1	1**	0	0	0	1	0	0	4**

55	Bashkia Lushnje		1	1	0.5	0	0	0	0	1	0	3.5
56	Bashkia Tepelenë		1	1*	0	1	0	0	0	0	0	3*
57	Bashkia Fushë-Arrëz	Nuk funksionon faqja		1*	1**	0	0	0	0	0	0	2***
58	Bashkia Divjakë	Nuk funksionon faqja		1*	1**	0	0	0	0	0	0	2***
59	Bashkia Fier	Nuk funksionon faqja		1*	1**	0	0	0	0	0	0	2***
60	Bashkia Kavajë	Nuk ka Program Transparence		1*	1**	0	0	0	0	0	0	2***
61	Bashkia Rrogozhinë	Nuk ka Program Model Transparence		1*	1**	0	0	0	0	0	0	2***
	Total (të plotë)		56	61	28	39	23	42	50	40	34	
	Total (të pjesshëm)		0	0	29	0	6	0	0	12	0	
	Total (nuk ka)		5	0	4	22	32	19	11	9	27	

Gjetjet përfundimtare “Indeksit i Transparencës Proaktive për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”


Në përfundim të monitorimit të kryer rezultojnë se:



13 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë proaktive të lartë” (semafor i gjelbër).



39 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë proaktive mesatare” (semafor i bardhë).




4 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë proaktive të ulët” (semafor i verdhë).



3 njësi të vetëqeverisjes vendore gjatë periudhës së monitorimit nuk kanë pasur faqe zyrtare aktive, 2 të tjera të cilat kanë faqe web aktive, nuk kanë publikuar Programin Model të Transparencës, e si rezultat janë vlerësuar me 0 pikë duke u shënuar në semafor me ngjyrë të kuqe për “Transparencë proaktive të pamjaftueshme” (në total 5 NjVV);

Në konkluzion të monitorimit të Transparencës Proaktive të njësive të vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2022, vërejmë se kemi një rritje të transparencës proaktive, duke marrë në konsideratë faktin se në këtë metodologji janë përdorur 9 indikatorë të cilët i korrespondojnë po aq kategorive të informacionit publik pa kërkesë që duhet të jenë të publikuara në faqen zyrtare të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore.

Ky përmirësim vihet re nëse do të krahasojmë në tre vitet e fundit 3 kategoritë kryesore të Programit të Transparencës: Publikimi i Programit Model të Transparencës, Caktimi i Koordinatorit për të Drejtën e Informimit dhe Përditësimi i Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve. Gjatë vitit 2022 vihet re një tendencë pozitive (sipas tabelës së mëposhtme), në të 3 indikatorët krahasur me vitin 2021, dhe akoma më shumë krahasuar me vitin 2020. Gjithashtu duke konsideruar grupimin e NjVV të renditura me rezultate më të mira në Indeksin e Transparencës, ato me semafor të gjelbër janë më të shumta në numër se ato NjVV të cilat janë renditur me semafor të verdhë dhe semafor të kuq. Objektivi i Zyrës së Komisionerit është që nëpërmjet vendimmarrjes së tij të arrij të rrisë numrin e NjVV, të cilat arrijnë të plotësojnë të gjithë indikatorët e transparencës proaktive dhe për këtë arsye të klasifikohen me semafor të gjelbër.



Rezultatet e këtij monitorimi tregojnë se 56 njësi të vetëqeverisjes vendore, kanë publikuar “Programin Model të Transparencës”. Në të njëjtin trend është edhe indikator i “Caktimit të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit”, ku të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë caktuar koordinatorin për të drejtën e informimit, por vetëm 57 prej tyre e kanë publikuar informacionin në faqen zyrtare, ndërkohë të gjithë të dhënat e koordinatorëve të njësive të vetëqeverisjes vendore janë të përditësuara në portalin www.pyetshtetin.al.

Në lidhje me “Publikimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve”, monitorimi evidenton me pikë pozitive vetëm ato raste kur regjistri është përditësuar për kërkesat e paraqitura gjatë vitit 2022. Numri total i njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilët kanë përditësuar regjistrin e kërkesave është 57, përkundrejt 61 bashkive të monitoruara. Megjithatë, vetëm 29 prej njësive të vetëqeverisjes vendore e kanë mbajtur regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuar sipas modelit të miratuar nga Zyra e Komisionerit, duke pasqyruar në të përveç objektit të kërkesës dhe përgjigjen e dhënë nga autoriteti, ndërsa 28 prej tyre nuk kanë reflektuar përgjigjen e dhënë, kërkesës.

Përsa i takon detyrimin lidhur me publikimin e informacionit proaktiv, i cili ka të bëjë me “Publikimi e Planit Buxhetor Afatmesëm 2022 - 2024 ”, është konstatuar se e kanë publikuar 39 autoritete publike, përkundrejt 61 të monitoruara (67%).


Gjatë vitit 2022 janë konstatuar mangësi më të theksuara mbi detyrimin “Raporte auditimi dhe monitorimi” përfshirë këtu raporte auditimi të brendshme dhe raporte auditimi të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Kjo është kategoria e informacionit më pak e publikuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Nga 61 njësi të vetëqeverisjes vendore rezulton se 23 prej tyre kanë publikuar të plotë këtë informacion, 6 e kanë publikuar të pjesshëm, ndërsa bashkitë e tjera nuk e kanë publikuar.

Për sa i përket publikimit të CV të Kryetarit të Bashkisë, 50 prej njësive të vetëqeverisjes vendore e kanë publikuar në faqen zyrtare, ndërkohë që 11 prej tyre nuk e kanë të publikuar.

Lidhur me indikatorin “Legjislacion”, këtë kategori informacioni e kanë publikuar 52 prej njësive të vetëqeverisjes vendore, ndërkohë që vetëm për 40 prej tyre është konsideruar informacion i plotë, ndërsa për 12 NjVV është konsideruar i pjesëshëm. Ndërkohë 9 bashki nuk e kanë publikuar kategorinë e informacionit “Legjislacion”.

Indikatorin i fundit i monitoruar ka të bëjë me të dhënat e “Koordinatorit për njoftimin dhe konsultim publik”, ku NjVV vazhdojnë të mos e kenë në vëmendje publikimin e të dhënave të këtij funksioni. Aktualisht rezultojnë se 34 NjVV i kanë publikuar të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik.

Transparenca Proaktive e NjVV



Nga rezultatet e monitorimit të Transparencës Proaktive të njëjësive të vetëqeverisjes vendore vihet re se në 8 kategori nga 9 të monitoruara numri i NjVV që kanë publikuar informacion të plotë kalon 50% e tyre.

Konkretisht Programi Model i Transparencës, Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Struktura Organizative e Bashkisë janë ndër dokumentat më të shpeshta të publikuara nga NjVV. Ndërsa “Plani Buxhetor Afatmesëm”, “CV e Kryetarit të Bashkisë”, “Legjislacioni” dhe “Të dhënat e Koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik”, janë publikuar në një numër më të lartë NjVV në krahasim me ato që nuk e kanë

publikuar. Vetëm në kategorinë “Raporte auditimi dhe monitorimi”, NjVV kalojnë në balancë negative në raport me mesataren e tyre, ndërsa për sa i përket kategorive të tjera të informacionit, publikimi i plotë i dokumentacionit qendron mbi mesataren. Gjetjet e këtij monitorimi dhe indeksi, synojnë jo vetëm të nxisin ndërgjegjësimin për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, si dhe rritjen e nivelit të transparencës përmes publikimit proaktiv të informacionit, por të shërbejnë dhe si një referencë përpara vendimmarrjes së Zyrës së Komisionerit në respektim të dispozitave ligjore. Sfidë mbetet për njësitë e vetëqeverisjes vendore jo vetëm miratimi dhe publikimi i Programit Model të Transparencës, por mbi të gjitha plotësimi me informacion i çdo dokumenti të parashikuar në të. Gjithashtu, sfida për Zyrën e Komisionerit mbetet dhe monitorimi i sa më shumë kategorive të informacionit të përfshira në indeksin e transparencës, si dhe përdorimi i të gjitha mekanizmave ligjore për të bërë të mundur jo vetëm ndërgjegjësimin, por dhe sanksionimin e personave përgjegjës për moszbatimin e transparencës proaktive.